



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 dhe nenit 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.11, nenit 25 të Ligjit nr. 03 / L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe në bazë të nenit 46, paragrafi 1 dhe 2 i Ligji nr. 04 / L-155 për sistemin e pagesave, Bordi i Bankës Qendrore në mbledhjen e mbajtur më 25 shkurt 2016, miratoi:

Rregulloren për regjistrin e llogarive bankare

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i funksioneve të regjistrin të llogarive bankare në Bankën Qendrore, mënyrën e raportimit dhe shfrytëzimit të të dhënave të llogarive bankare, si dhe qasjen dhe shfrytëzimin e këtij Regjistri nga pjesëmarrësit.

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo rregullore zbatohet për të gjitha bankat komerciale që veprojnë në Kosovë dhe të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

Neni 3 Përkufizimet

1. Përkufizimet për qëllim të kësaj rregulloreje kanë këto kuptime:
 - 1.1. "**Banka Qendrore**" nënkupton Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës
 - 1.2. "**Regjistri i llogarisë bankare**" nënkupton infrastrukturën në lidhje me bazën e të dhënave të themeluar nën autoritetin e Bankës Qendrore, e cila përmban të gjitha informatat mbi llogaritë bankare në bankat komerciale që veprojnë në Kosovë, në mënyrë që të shfrytëzojnë këto të dhëna dhe për të lehtësuar zbatimin dhe ekzekutimin e vendimeve zbatuese që kanë të bëjnë me detyrimet në të holla.
 - 1.3. "**Poseduesi i llogarisë**" nënkupton personin fizik ose juridik që është klient i bankave komerciale dhe i cili ka hapur llogari bankare në bankën përkatëse.
 - 1.4. "**Ofruesi i të dhënave të llogarive**" nënkupton institucionin financiar të licencuar nga Banka Qendrore si bankë komerciale.
 - 1.5. "**Subjekti i të dhënave**" i referohet personit prej të cilit janë mbledhur informatat për llogaritë/ llogaritë bankare dhe janë përpiluar në Regjistrin e llogarive bankare. Subjektet

e të dhënave përfshijnë personat fizikë dhe juridikë të cilët kanë llogari bankare në cilëndo bankë komerciale që veprojnë në Kosovë, të dhënat dhe informatat mbledhen në Regjistrin e llogarive bankare dhe janë në dispozicion sipas kësaj rregulloreje.

- 1.6. **“Informatat e llogarisë bankare”** nënkupton informatat që janë të renditura në nenin 6, nënparagrafët **1.1-1.3**“
- 1.7. **“Person juridik”** nënkupton çdo subjekt, duke përfshirë organizatat afariste, organizata joqeveritare, të cilat kanë identitet ligjor të ndarë dhe të ndryshëm nga anëtarët, pronarët apo aksionarët.
- 1.8. **“Person fizik”** nënkupton dhe i referohet vetëm personit fizik.
- 1.9. **“Të dhëna personale”** nënkupton çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar.
- 1.10. **“Të dhënat personale të ndjeshme”** nënkupton çdo informacion personal që zbulon origjinën racore ose etnike, mendimet politike ose filozofike, besimet fetare, anëtarësimin në sindikata, gjendjen shëndetësore, orientimin seksual, karakteristikat biometrike ose kundërvajtjet apo statusin penal.
- 1.11. **“Udhëzim”** nënkupton rekomandimin me shkrim të lëshuar nga Banka Qendrore i cili gjen zbatim të përgjithshëm dhe është i detyrueshëm në tërësinë e saj dhe është drejtpërdrejt e zbatueshme.
- 1.12. **“Debitor”** nënkupton çdo person fizik apo juridik kundrejt të cilit është realizuar kërkesa monetare në bazë të vendimit të marrë në procedurën e përmbarimit në bazë të Ligjit për procedurën përmbarimore.
- 1.13. **“Kreditor”** nënkupton personin fizik ose juridik kërkesa monetare e të cilit është përbushur në bazë të vendimit të marrë në procedurën e përmbarimit në bazë të Ligjit për procedurën përmbarimore.
- 1.14. **“Organet e përmbarimit”** i referohen organeve të përmbarimit të përcaktuara me Ligjin për procedurën përmbarimore.
- 1.15. **“Vendimi i përmbarimit”** [ose “vendimi i prerë i përmbarimit”] është përcaktuar me nenin 24 të Ligjit për procedurën përmbarimore.

Neni 4

Funksionet e Regjistrin të llogarisë bankare

1. Regjistri i llogarisë bankare përfaqëson një infrastrukturë të bazës së të dhënave të krijuar në kuadër të Bankës Qendrore, e cila mundëson:
 - 1.1. Raportimin e të dhënave për xhirollogarinë nga ofruesit e të dhënave të llogarive (bankat komerciale);
 - 1.2. Shfrytëzimi i të dhënave në funksion të zbatimit të vendimeve të prera të përmbarimit të shërbyera nga organet e përmbarimit dhe institucionet e tjera kompetente sipas dispozitave të Ligjit për procedurën përmbarimore.
2. Nëpërmjet Regjistrin të llogarive bankare është mundësuar shkëmbimi elektronik i vendimeve në debi dhe bllokimi i llogarive bankare të debitorëve, në bazë të vendimeve të plotfuqishme të organeve të zbatimit dhe institucioneve të tjera në bazë të Ligjit mbi procedurën përmbarimore.

3. Regjistri i llogarive bankare do të shërben si mekanizëm i komunikimit elektronik ndërmjet bankave dhe organeve të zbatimit të institucioneve të tjera ku Ligji mbi procedurën përmbartimore ia përcakton të merret me zbatimin e vendimeve finale, ku obligimi është në vlerë monetare.

Neni 5

Roli i Bankës Qendrore ndaj Regjistrit të llogarive bankare

1. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës e udhëheq Regjistrin e llogarive bankare , në të njëjtën kohë mirëmban dhe administron infrastrukturën teknike të regjistrit, harduerin, softuerin, rrjetin, sigurinë e qasjes, etj.
2. Ajo administron qasjen në Regjistër për pjesëmarrësit dhe përdoruesit e saj.
3. Ajo gjeneron raporte statistikore në vazhden e monitorimit të raportimit të llogarive nga ofruesit e të dhënave, si dhe për nevojat e analizave të tjera të ndryshme.

Neni 6

Mbledhja e informatave

1. Në pajtim me këtë rregullore, në Regjistrin e llogarive bankare do të mblidhen dhe mirëmbahen të dhënat për mbajtësit e llogarive, së paku si në vijim:
 - 1.1. Numri i llogarisë bankare i secilës llogari të hapur nga mbajtësi i llogarisë në njërin nga bankat komerciale të licencuara dhe që operojnë në Kosovë, përfshirë datën e hapjes dhe përditësimin e llogarisë, si dhe statusin (aktive, joaktive, të bllokuar, mbyllur, etj) e llogarisë;
 - 1.2. Informacioni i përgjithshëm identifikues përfshirë emrin e plotë të personit fizik dhe/ose juridik, numrin identifikues dhe adresën;
 - 1.3. Informacioni mbi historikun e statusit të llogarisë përfshirë datën dhe përshkrimin e arsyes për ndryshimin e statusit.
2. Regjistri i llogarive bankare nuk do të grumbullojë, mbajë apo raportojë këto informacione mbi këtë temë:
 - 2.1. Llogarinë e bilancit dhe depozitat në llogari ose llogaritë bankare, dhe
 - 2.2. Të dhënat e ndjeshme personale siç përcaktohet me Ligjin mbi mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 7

Raportimi i informacionit

1. *Kërkesa për raportim.* Të gjithë ofruesit e të dhënave të llogarisë kërkohet të raportojnë në Regjistrin e llogarive bankare të gjitha informacionet e përcaktuara në nenin 6, paragrafi 1 i kësaj rregulloreje.
2. *Standardi i raportimit.* Ofruesit e të dhënave të llogarisë duhet të ofrojnë informacion të saktë, me kohë dhe të kompletuar mbi logarinë bankare në Regjistrin e llogarive bankare në pajtim me këtë rregullore apo ndonjë instruksion tjetër.

3. *Përmirësimi i të dhënave.* Në në ndonjë moment, ofruesi i të dhënave të mbajtësit të llogarisë bankare përcakton se informata e ofruar nuk është e kompletuar, e dërguar në kohë apo e saktë, e njëjta duhet të ndërmarrë të gjithë hapat për të siguruar informacionin e plotë, në kohë dhe saktë dhe t'i dorëzojë ato në Regjistrin e llogarive bankare.

Neni 8

Qasja dhe përdorimi i Regjistrin të llogarive bankare

1. Subjektet që do të kenë qasje dhe të përdorin informacionin nga llogaritë bankare janë:
 - 1.1. Organet zbatuese siç përcaktohen me Ligjin mbi procedurën përmbarimore;
 - 1.2. Institucionet e tjera që i pasqyrojnë vendimet në procedura administrative dhe kundërvajtje me të cilën është përcaktuar obligimi monetar, siç përcaktohet dhe rregullohet me paragrafin 2 të nenit 1 të Ligjit mbi procedurën përmbarimore.

Neni 9

Përdorimi i informacionit

1. Subjektet që u lejohe të kenë qasje në Regjistrin e llogarive bankare janë specifikuar në nenin 8 të kësaj rregulloreje dhe do të përdorin informatën e llogarisë bankare vetëm për qëllime për të cilat janë kërkuar dhe jo për qëllime të tjera;
2. Subjektet që u lejohe të kenë qasje në informacionin e llogarisë bankare në Regjistrin e llogarive bankare nuk duhet të shpërndajnë informata të llogarisë bankare palëve të treta, përveç nëse e njëjta kërkohet me ligj apo me urdhër të gjykatës si gjykatë kompetente.
3. Subjektet që u lejohe të kenë qasje në këtë Regjistër do të jenë përgjegjëse për përcaktimin e përgjegjësiave, autorizimeve dhe të drejtat e qasjes në regjistrin për zyrtarët e saj, si dhe për emërimin e një zyrtari kontaktues për kontaktim me BQK-në sa i përket kërkesave për hapjen/mbylljen e përdoruesve dhe çështjeve të tjera të lidhura.
4. BQK-ja do të nënshkruajë marrëveshjen me subjektet e kualifikuara që kanë të drejtë për qasje dhe përdorim të informatave në Regjistrin e llogarive bankare.

Neni 10

Të drejtat e poseduesve të llogarive

1. Poseduesit e llogarisë mbajnë të drejtën e tyre të privatësisë së të dhënave personale në pajtim me ligjin.
2. Poseduesit e llogarisë do të kenë mundësi për të kërkuar informata përkatëse nga ofruesit e të dhënave të llogarisë.
3. Ofruesit e të dhënave për llogaritë do të ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar, që ata të jenë në gjendje të raportojnë si duhet informatat për subjektin e të dhënave për Regjistrin e llogarive bankare.
4. Ofruesit e të dhënave të llogarive do t'i raportojnë informatat mbi subjektin e të dhënave tek regjistri i llogarive bankare brenda 30 minutave pas hapjes së llogarisë së re bankare

ose pas ndërrimit të statusit (mbyllje, pasivizim, bllokim etj.) i një llogarie ekzistuese të një poseduesi të llogarisë bankare .

5. Poseduesit e llogarive bankare kanë të drejtë të kundërshtojnë dhe të kërkojnë për përmirësimin e informatave personale për llogarinë bankare nga ofruesit e të dhënave.
6. Dispozitat e këtij neni nuk do të ndalojnë ose kufizojnë kërkesën për paraqitjen e informatave shtesë nga subjekti i të dhënave të përcaktuar me ndonjë ligj ose rregullore.

Neni 11

Ndëshkimet për moszbatimin e rregullores

1. Ofruesit e të dhënave të llogarive bankare për të cilët konstatohet se kanë shkelur këtë rregullore do të jenë subjekt i ndëshkimeve administrative të specifikuara në nenin 67 të Ligjit mbi Bankën Qendrore ose ndonjë ligji tjetër relevant .
2. Shkeljet që mund të rezultojnë me ndëshkime administrative përfshijnë por nuk kufizohen në:
 - 2.1. Raportimi i vonuar i informatave për poseduesin e llogarisë bankare, do të ketë ndëshkim prej 200 Euro;
 - 2.2. Dështimi për të raportuar informatat mbi poseduesin e llogarisë, do të ketë ndëshkim prej 500 Euro;
 - 2.3 Raportimi i pasaktë i informatave për poseduesin e llogarisë bankare, do të ketë ndëshkim prej 700 Euro;
 - 2.4 Raportimin e qëllimshëm të pasaktë të të dhënave për poseduesin e llogarisë bankare, do të ketë ndëshkim prej 1,000 Euro;
 - 2.5 Keqpërdorimi i raporteve për poseduesin e llogarive bankare nga ana e ofruesve të të dhënave të llogarive bankare, do të ketë ndëshkim prej 1,500 Euro, dhe
 - 2.6 Publikimi i paautorizuar i informatave konfidenciale për poseduesit e llogarive bankare, do të ketë ndëshkim prej 5,000 Euro;
3. Shqiptimi i ndëshkimeve administrative nga ana e Bordit Ekzekutiv të përcaktuar me këtë nen, nuk përjashton shqiptimin e ndonjë përgjegjësie civile ose penale sipas dispozitave të ndonjë ligji tjetër relevant.

Neni 12

Udhëzimet për funksionimin e Regjistrimit

Në kuadër të kornizës dhe kërkesave të përcaktuara në këtë rregullore, si dhe në përputhje me Ligjin e BQK-së dhe Ligjin për sistemin e pagesave, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore do të nxjerrë udhëzimet për funksionimin e Regjistrimit të llogarisë bankare.

Neni 13
Dispozitat kalimtare

1. Për llogaritë të cilat janë hapur para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, ofruesit e të dhënave të llogarive bankare janë të obliguar që të dhënat t'i bartin në Regjistrin e llogarive bankare;
2. Ofruesit e të dhënave të llogarive bankare janë të obliguar që të përshtatin sistemin e tyre për raportim automatik në Regjistrin e llogarive bankare, brenda gjashtë (6) muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

Neni 14
Tarifat

Banka Qendrore mund të vendosë tarifa për pjesëmarrësit në sistemin e Regjistrin të llogarive bankare, dhe këto fonde do të përdoren për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit.

Neni 15
Shfuqizimi

Pas hyrjes në fuqi të kësaj rregullore, do të shfuqizohet Rregullorja për regjistrin e poseduesve të llogarive bankare e miratuar më 5 prill 2012.

Neni 16
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më 1 mars 2016.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Prof. Dr. Bedri Peci